

Sacred Scriptures—the Foundations of Faith

By Elder Quentin L. Cook
Of the Quorum of the Twelve Apostles

Shkrimet e Shenjta – Themelet e Besimit

Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

October 2024 general conference

We cannot underestimate the significance of sacred scriptures both in conversions and in remaining faithful in the gospel.

My wife, Mary, and I recently saw a T-shirt with the picture of a book and a message on the front which read, “Books: The Original Handheld Device.”

I thought about this interesting message and how significant handheld devices of all kinds have become. Upon further contemplation, I realized that any device or even one equipped with artificial intelligence will never be as important or significant as the spiritual guidance that comes from divine revelation.

Whether handheld or digital, the Holy Bible and the Book of Mormon: Another Testament of Jesus Christ provide spiritual guidance and teaching from Jesus Christ, the Savior of the world. We treasure these books for their profound role in documenting God’s direction to ancient prophets and people and the guidance they provide for our own personal lives.

Combined with the teachings of living prophets, these sacred scriptures provide doctrinal direction for us in today’s world. These scriptures are most powerful when they give instruction, correction, comfort, and consolation to individuals and families who seek guidance from the Lord.

The scriptures, combined with spiritual inspiration from the Holy Spirit, continue to be the primary source that facilitates the conversion of those who have broken hearts and contrite spirit—and desire to follow Jesus Christ. The scriptures help build a foundation that can withstand the

Nuk mund të nënvleftësojmë rëndësinë e shkrimeve të shenjta, si në kthimin në besim, ashtu dhe në qëndrimin besnikë ndaj ungjillit.

Bashkëshortja ime, Meri, dhe unë, kohët e fundit pamë një bluzë me mëngë të shkurtra me figurën e një libri dhe një mesazh përpara ku thuhej: “Librat: Mjeti Fillestar i Mbajtur në Dorë”.

Mendova për këtë mesazh interesant dhe se sa domethënëse janë bërë mjetet e të gjitha llojeve që mbahen në dorë. Pas të menduarit të mëtejshëm e kuptova se çfarëdo mjeti ose edhe një mjet i pajisur me inteligjencë artificiale nuk do të jetë kurrë po aq i rëndësishëm ose domethënës sa udhërrëfimi shpirtëror që vjen nga zbulesa hyjnore.

Qoftë të mbajtur në dorë apo digjitale, Bibla e Shenjtë dhe Libri i Mormonit: Një Dëshmi Tjetër e Jezu Krishtit sigurojnë udhërrëfim dhe mësim nga Jezu Krishti, Shpëtimtari i botës. Ne i ruajmë si thesare këta libra për rolin e tyre të thellë në dokumentimin e udhëzimit nga Perëndia të profetëve dhe njerëzve të lashtë dhe të udhërrëfimit që ata japin për vetë jetën tonë personale.

Të ndërthurura me mësimet e profetëve të gjallë, këto shkrime të shenjta japin udhëzim doktrinor për ne në botën e sotme. Këto shkrime të shenjta janë më të fuqishme kur ato u japin udhëzim, korrigjim, rehati dhe ngushëllim individëve dhe familjeve që kërkojnë udhërrëfim nga Zoti.

Shkrimet e shenjta, të ndërthurura me frymëzim shpirtëror nga Shpirti i Shenjtë, vazhdojnë të jenë burimi parësor që e lehtëson kthimin në besim të atyre që kanë “zemra të thyera dhe ... shpirtra të penduar” dhe dëshirojnë ta ndjekin Jezu Krishtin. Shkrimet e shenjta ndihmojnë për

adversary's constant efforts to undermine faith.

New converts have blessed and been the lifeblood of the Church throughout its history. One example is particularly precious to me. When I was a young bishop, two marvelous sister missionaries were teaching the William Edward Mussman family. The father, a very capable lawyer, was general counsel of a major corporation. His devoted wife, Janet, was helping the family strive to live a more Christlike life.

Their exceptional son and daughter, both in their early 20s, were also being taught. All four had received the lessons and were attending church. The sister missionaries had emphasized reading the Book of Mormon and praying for a testimony of that sacred scripture. Remarkably, the family prayerfully read the entire Book of Mormon in a short time.

The stake missionaries, both of whom were prior ward Relief Society presidents, accompanied them to sacrament meetings.

As the family was nearing baptism, they received a barrage of literature critical of the Church. This was before the internet, but the material filled a large cardboard box.

The sister missionaries invited me as a recently called 34-year-old bishop to help answer the questions being raised. When we gathered in their living room, the large box of pamphlets critical of the Church was in the middle of the room. I had prayerfully approached this assignment. During the opening prayer, the Spirit whispered to me, "He already knows it is true." This was important. The sisters believed that the rest of the family already had a testimony. They were unsure about the father.

I immediately informed him that the Spirit had prompted me that he already had a testimony. "Was that true?" He looked at me intently and said that the Spirit had confirmed the truth of the Book of Mormon and the Church to him.

I then asked whether it would be necessary to review the pamphlets, if they already had a spiritual confirmation.

The father replied that it would not be necessary. The rest of the family concurred with his

të ndërtuar një themel që mund t'u bëjë ballë përpjekjeve të vazhdueshme të kundërshtarit për ta gërryer besimin.

Të kthyerit e rinj në besim e kanë bekuar Kishën dhe kanë qenë gjaku jetëdhënës i Kishës gjatë gjithë historisë së saj. Një shembull është veçanërisht i çmuar për mua. Kur isha peshkopi i ri në moshë, dy motra të mrekullueshme misionarepo i jepnin mësim familjes së Uilliam Eduard Masmanit. Babai, një avokat shumë i zoti, ishte avokati kryesor i një korporate të madhe. Bashkëshortja e tij e përkushtuar, Xheneta, po e ndihmonte familjen që të përpiquej fort për të jetuar një jetë më shumë si Krishti.

Biri dhe bija e tyre, që ishin të jashtëzakonshëm, që të dy në fillim të të njëzetave, gjithashtu po merrnin mësimet. Të katër i kishin marrë mësimet dhe po e frekuentonin kishën. Motrat misionare e kishin vënë theksin te leximi i Librit të Mormonit dhe te lutja për një dëshmi të atij shkrimi të shenjtë. Në mënyrë mbresëlënëse, familja plot lutje e lexoi të gjithë Librin e Mormonit brenda një kohe të shkurtër.

Misionaret e kishin, të cilat që të dyja kishin qenë më parë presidente të Shoqatës së Ndihmës së lagjes, i shoqëronin ata në mbledhjet e sakramentit.

Teksa familja po i afrohej pagëzimit, u erdhi një mori literature kritikuese ndaj Kishës. Kjo ishte përpara kohës së internetit, por materiali ishte sa një kuti e madhe kartoni.

Motrat misionare më ftuan mua si një peshkop i sapothirrur 34-vjeçar që të ndihmoja për t'u dhënë përgjigje pyetjeve që qenë ngritur. Kur u mbledhëm në dhomën e tyre të ndenjjes, kutia e madhe me pamfletet kritikuese ndaj Kishës ishte në mes të dhomës. I isha drejtuar plot lutje kësaj detyre. Gjatë lutjes së hapjes, Shpirti më pëshpëriti: "Ai tashmë e di se është e vërtetë". Kjo ishte e rëndësishme. Motrat besonin se pjesa tjetër e familjes tashmë e kishte një dëshmi. Ato nuk ishin të sigurt për babanë.

Menjëherë e njoftova atë se Shpirti më kishte nxitur që ai tashmë e kishte një dëshmi. "A ishte kjo e vërtetë?" Ai më vështroi me qëllim dhe tha se Shpirti i kishte pohuar atij të vërtetën për Librin e Mormonit dhe Kishën.

Pastaj e pyeta a do të ishte e nevojshme t'i shqyrtonim pamfletet, duke qenë se ata tashmë e kishin një vërtetim shpirtëror.

Babai tha se nuk do të ishte e nevojshme. Pjesa tjetër e familjes ishte në një mendje me

answer.

He said he did have a significant question: One reason they had received so much literature opposing the Church was that they were members of another faith. In addition, he had made a large pledge to help build a new chapel for that faith. He informed me that the sister missionaries had taught him about the importance of tithing, which he gratefully accepted, but he wondered if it would be wrong to also honor the pledge he had previously made. I assured him that payment of the pledge would be both honorable and appropriate.

The Mussmans with their son, daughter-in-law, and daughter.

The entire family was baptized. One year later they were sealed as a family in the Oakland California Temple. I was privileged to be present. The son completed law school, passed the California Bar Exam, and immediately served a faithful mission in Japan. I have watched over the years as the succeeding generations have remained faithful to the gospel. I was privileged to officiate at the sealing of one of the granddaughters.

The conversions that are occurring in our day are equally remarkable. Last June, Coach Andy Reid, head football coach of the Kansas City Chiefs, and I, along with others representing our faith and other faiths, spoke in a multifaith event at the Riverside Church in New York City. Coach Reid emphasized second chances and responding to invitations and opportunities, which is what the gospel of Jesus Christ is all about. The next morning, with our wives, Tammy Reid and Mary, we attended the sacrament meeting at the Manhattan Second Ward. It was a spiritual service. There were many new converts in the congregation. Five recently baptized members, four men and one young man, were among the Aaronic Priesthood members passing the sacrament. I am happy to report that a similar influx of new members is happening throughout the Church.

We are grateful for the noticeable increase in those who respond to sacred invitations, change their lives, and accept the opportunity to follow Jesus Christ. They enter the covenant path through faith, repentance, baptism, and confirmation as taught in the Holy Bible and the Book

përgjigjen e tij.

Ai tha se kishte një pyetje të rëndësishme: Një arsye përse kishin marrë kaq shumë literaturë kundër Kishës, ishte se ata ishin anëtarë të një besimi tjetër fetar. Përveç kësaj, ai kishte bërë një zotim për një shumë të madhe parash që të ndihmonte të ndërtohej një godinë e re kishtare për atë besim fetar. Ai më njoftoi se motrat misionare i kishin mësuar rreth rëndësisë së të dhjetës, të cilën ai e kishte pranuar plot mirënjohje, por ai pyeste veten a do të ishte e gabuar që gjithashtu të mbante zotimin që kishte bërë më parë. E sigurova se ai pagim i zotimit do të ishte si i nderuar, ashtu edhe me vend.

Familja Masman me birin e tyre, nusen dhe bijën.

E tërë familja u pagëzua. Një vit më vonë, ata u vulosën si familje në Tempullin e Oklandit në Kaliforni. Pata privilegjin që të isha i pranishëm. I biri mbaroi shkollën juridike, kaloi provimin e jurisprudencës për shtetin e Kalifornisë dhe menjëherë shërbeu në një mision plot besnikëri në Japoni. Kam vëzhguar përgjatë viteve tekса brezat pasues kanë qëndruar besnikë ndaj ungjillit. Pata privilegjin që të kryesoja në vulosjen e njëres prej mbesave.

Kthimet në besim që po ndodhin në kohën tonë, janë po aq mbresëlënëse. Qershorin e kaluar, trajneri Endi Rid, trajneri kryesor i ekipit Kansas Siti Çifs në futbollin amerikan, dhe unë, së bashku me të tjerë që përfaqësonim besimin tonë dhe besime të tjera fetare, folëm në një ngjarje të shumë besimeve fetare në kishën Rivërsajd në Nju-Jork-Siti. Trajneri Rid theksoi shanset e dyta dhe përgjigjen ndaj ftesave dhe mundësive, për të cilat flitet në ungjillin e Jezu Krishtit. Të nesërmen në mëngjes, me bashkëshortet tona, Temi Ridin dhe Merin, frekuentuam mbledhjen e sakramentit në Lagjen e Dytë të Manhatanit. Ishte një shërbesë shpirtërore. Pati shumë të kthyer në besim të rinj në atë bashkësi. Pesë anëtarë të pagëzuar kohët e fundit, katër burra dhe një djalë i ri në moshë, ishin mes anëtarëve të Priftërisë Aarone që shpërndanin sakramentin. Jam i lumtur të raportoj se një dyndje e ngjashme e anëtarëve të rinj po ndodh anëmbanë Kishës.

Jemi mirënjohës për rritjen e dukshme në numër të atyre që u përgjigjen ftesave të shenjta, e ndryshojnë jetën dhe e pranojnë mundësinë për të ndjekur Jezu Krishtin. Ata hyjnë në shtetun e besëlidhjeve nëpërmjet besimit, pendimit, pagëzimit dhe konfirmimit siç u dha mësim në

of Mormon.

We cannot underestimate the significance of sacred scriptures both in conversions and in remaining faithful in the gospel. The ancient prophets described in the Book of Mormon knew about the mission of Jesus Christ and taught His gospel. The Book of Mormon helps us draw closer to God as we learn, understand, and apply its teachings. The Prophet Joseph Smith taught, “A man [or woman] would get nearer to God by abiding by [the book’s] precepts, than by any other book.”

To know that the Book of Mormon is the word of God, we need to read, ponder, and pray about it and then act according to its precepts. The prophet Moroni promised that God will reveal the truth of the book to us as we pray with a sincere heart, with real intent, and with faith in Christ. Studying the Book of Mormon is essential for enduring conversion.

As we contemplate the relationship between the Bible and the Book of Mormon as handheld devices, one might ask a question. How useful and complementary do you think two books would be if the Lord declared they would be joined together and “become one in thine hand”? That is what the Lord declared concerning the “stick of Judah,” the Bible, and the “stick of Joseph,” the Book of Mormon.

In many significant respects, the Book of Mormon provides fundamental doctrine that enhances and builds upon the Bible. The doctrine of the Atonement of Jesus Christ is a profound example.

The Bible provides an accurate account of the mortal ministry of Jesus Christ, including His death and Resurrection. The Book of Mormon is more explicit about the Atonement of Jesus Christ, something prophets explained in detail prior to His death.

The heading to Alma chapter 42 reflects the doctrinal significance of the Atonement of Jesus Christ.

It reads: “Mortality is a probationary time to enable man to repent and serve God—The Fall brought temporal and spiritual death upon all mankind—Redemption comes through repentance—God Himself atones for the sins of the world—Mercy is for those who repent—All

Biblën e Shenjtë dhe Librin e Mormonit.

Nuk mund të nënvleftësojmë rëndësinë e shkrimeve të shenjta, si në kthimin në besim, ashtu dhe në qëndrimin besnikë ndaj ungjillit. Profetët e lashtë, të përshkruar në Librin e Mormonit, qenë në dijeni për misionin e Jezu Krishtit dhe e dhanë mësim ungjillin e Tij. Libri i Mormonit na ndihmon të afrohem me shumë me Perëndinë ndërsa i mësojmë, i kuptojmë dhe i zbatojmë mësimet e tij. Profeti Jozef Smith dha mësim: “Një njeri do t’i afrohet më shumë Perëndisë duke iu bindur porositë të [librit], se nga [cilido] libër tjetër”.

Për të ditur që Libri i Mormonit është fjala e Perëndisë, kemi nevojë ta lexojmë, të përsiatim dhe të lutemi për të dhe më pas të veprojmë sipas parimeve të tij. Profeti Moroni premtoi se Perëndia do të na e zbulojë të vërtetën e librit ndërsa lutemi me një zemër të sinqertë, me qëllim të vërtetë dhe me besim te Krishti. Studimi i Librit të Mormonit është thelbësor për një kthim afatgjatë në besim.

Ndërkohë që mendojmë për lidhjen midis Biblës dhe Librit të Mormonit si mjete që mbahen në dorë, dikush mund të bëjë një pyetje. Sa të dobishëm dhe plotësues mendoni se do të ishin të dy librat, në qoftë se Zoti shpallte që ata do të bashkoheshin së bashku dhe do të “bëhe[shi]n një gjë e vetme në dorën [tonë]”? Kjo është ajo që Zoti shpalli lidhur me “copën e drurit të Judës”, Biblën, dhe “copën e drurit të Jozefit”, Librin e Mormonit.

Në shumë aspekte të rëndësishme, Libri i Mormonit siguron doktrinën themelore që lartëson dhe ndërton mbi Biblën. Doktrina e Shlyerjes së Jezu Krishtit është një shembull i thellë.

Bibla jep një rrëfim të saktë të shërbesës së Jezu Krishtit në vdekshmëri, përfshirë vdekjen dhe Ringjalljen e Tij. Libri i Mormonit është më i qartë rreth Shlyerjes së Jezu Krishtit, diçka që profetët e shpjeguan me hollësi përpara vdekjes së Tij.

Kreu tek Alma kapitulli 42 pasqyron rëndësinë doktrinale të Shlyerjes së Jezu Krishtit.

Aty thuhet: “Vdekshmëria është një periudhë prove për t’i dhënë mundësi njeriut të pendohet dhe t’i shërbejë Perëndisë – Rënia solli vdekje trupore dhe shpirtërore mbi gjithë njerëzimin – Shpëtimi vjen nëpërmjet pendimit – Perëndia vetë shlyen për mëkatet e botës – Mëshira është

others are subject to God's justice—Mercy comes because of the Atonement—Only the truly penitent are saved.”

President Russell M. Nelson has said, “I promise that as you prayerfully study the Book of Mormon every day, you will make better decisions—every day.” He also promises that if “you daily immerse yourself in the Book of Mormon, you can be immunized against the evils of the day.”

As I mentioned, I was impressed with the concept of the original handheld device—a book. However, I recognize the incredible significance of the internet in the world today. One modern handheld device can provide the information that historically has filled a major library. We are grateful to live in such a time as this. I am particularly grateful that it allows sacred books and Church materials to be available digitally. The internet is a powerful tool for studying the gospel. Today, many people share scriptures with friends using technology. The Book of Mormon app, for example, is a wonderful way to introduce friends to the Book of Mormon and can easily be shared in normal and natural ways wherever you may be.

While the internet provides many blessings, unfortunately, like the written pamphlets critical of the Church I described earlier, it has also been used to create doubt and undermine faith in precious gospel principles. It can be part of the “evils of the day” that President Nelson mentioned.

The adversary and those who assist him, knowingly or unwittingly, have created on the internet the equivalent of the box full of written material critical of the Church I described earlier, intended to draw you away from God's truth.

The issues raised to create doubt over the years have been remarkably similar. This is especially true when you compare our day with the 1960s, when I was in my 20s.

The scriptures teach us to use judgment and be wise in all things. The internet can be used in a positive way or a destructive way.

Both long-term members and those new-

për ata që pendohen – Gjithë të tjerët duhet t'i nënshtrohen drejtësisë së Perëndisë – Mëshira vjen për shkak të shlyerjes – Vetëm të penduarit e vërtetë, shpëtohen”.

Presidenti Rasëll M. Nelson ka thënë: “Unë ju premtoj se kur e studioni me lutje Librin e Mormonit çdo ditë, ju do të merrni vendime më të mira – çdo ditë”. Ai gjithashtu premtoi që, nëse “e zhytni veten përditë në Librin e Mormonit, ju mund të fitoni imunitet kundër të ligave të ditës”.

Siç e përmenda, më la mbresë koncepti i mjetit fillestar të mbajtur në dorë – një libër. Sidoqoftë, unë e dalloj rëndësinë e pabesueshme të internetit në botë sot. Një mjet bashkëkohor që mbahet në dorë, mund të sigurojë informacionin që historikisht ka mbushur një bibliotekë të madhe. Jemi mirënjohës që jetojmë në një kohë si kjo. Jam veçanërisht mirënjohës që i lejon librat e shenjtë dhe materialet e Kishës për të qenë në dispozicion në mënyrë digjitale. Interneti është një mjet i fuqishëm për të studiuar ungjillin. Sot, shumë njerëz shpërndajnë shkrime të shenjta te miqtë duke përdorur teknologjinë. Për shembull, programi elektronik për Librin e Mormonit është një mënyrë e mrekullueshme për t'ua paraqitur miqve Librin e Mormonit dhe mund të shpërndahet lehtësisht në mënyra të zakonshme dhe të natyrshme kudo ku mund të jeni.

Ndërkohë që interneti siguron shumë bekime, për fat të keq, si pamfletet e shkruara, kritikuese ndaj Kishës që i përshkrova më parë, gjithashtu është përdorur për të krijuar dyshim dhe për të gërryer besimin në parimet e çmuara të ungjillit. Ai mund të jetë pjesë e “të ligave të ditës” që i përmendi Presidenti Nelson.

Kundërshtari dhe ata që e ndihmojnë atë me vetëdije ose padashur, kanë krijuar në internet të barasvlefshmen e një kutie plot me materiale të shkruara, kritikuese ndaj Kishës që i përshkrova më parë, me qëllimin që t'ju largojnë nga e vërteta e Perëndisë.

Çështjet e ngritura për të krijuar dyshim përgjatë viteve, kanë qenë jashtëzakonisht të ngjashme. Kjo është veçanërisht e vërtetë kur e krahasoni kohën tonë me vitet 1960, kur unë isha në fillim të të njëzetave.

Shkrimet e shenjta na mësojnë të përdorim gjykim dhe të jemi të mençur në të gjitha gjërat. Interneti mund të përdoret në mënyrë pozitive ose në mënyrë shkatërrimtare.

Si anëtarët prej një kohe të gjatë, ashtu edhe

ly studying the gospel need to be intentional about what they view. Do not entertain immoral, dishonest, or unrighteous material. If you do, algorithms can lead you down a path that destroys faith and impairs your eternal progression. You can be acted upon positively or negatively. Seek righteousness and avoid dark internet rabbit holes and doomscrolling. Fill your life with positive, righteous ideas; be joyful; have fun but avoid foolishness. There is a difference. The thirteenth article of faith is a marvelous guide. Above all, immerse yourself regularly in the Book of Mormon, which will draw the Spirit into your life and help you discern truth from error.

My counsel for those who have in any way deviated from the covenant path is to return to the sacred scriptures, prophetic guidance, religious observance in the home, and the music of faith. Every soul is precious to the Lord. We need you! The Lord needs you, and you need Him! You will always be welcome. During my many years of Church service, I have cherished the wonderful people who returned to the covenant path and then served and blessed everyone they loved or with whom they came in contact.

The sacred scriptures and living prophets are a major way a loving Heavenly Father makes His plan of happiness available to all His children.

I bear my sure witness of the divinity of Jesus Christ and the reality of His Atonement, in the name of Jesus Christ, amen.

ata që sapo po e studiojnë ungjillin, nevojitet të jenë të qëllimshëm rreth asaj që shikojnë. Mos merrni në shqyrtim materiale të pamoralshme, të pandershme ose të padrejta. Nëse e bëni, algoritmet mund t'ju çojnë nëpër një shteg që e shkatërron besimin dhe e dëmton përparimin tuaj të përjetshëm. Mbi ju mund të veprohet pozitivisht ose negativisht. Kërkoni drejtësinë dhe shmanguni situatave të çuditshme dhe gjëmëkllikimit në Internet. Mbusheni jetën tuaj me ide pozitive, të drejta; jini plot gëzim; argëtohuni por shmanguni budallallëkut. Ka ndryshim. Neni i 13-të i besimit është një udhërrëfyes i mrekullueshëm. Mbi të gjitha, zhyteni veten rregullisht në Librin e Mormonit, i cili do ta tërheqë Shpirtin në jetën tuaj dhe do t'ju ndihmojë që të dalloni të vërtetën nga gabimi.

Këshilla ime për ju që në njëfarë mënyre jeni shmangur nga shtegu i besëlidhjeve, është që të ktheheni te shkrimet e shenjta, udhërrëfimi profetik, respektimi i fesë në shtëpi dhe muzika plot besim. Çdo shpirt është i çmuar për Zotin. Ne kemi nevojë për ju! Zoti ka nevojë për ju dhe ju keni nevojë për Të! Do të jeni të mirëpritur përherë. Gjatë viteve të shumta të shërbimit në Kishë, jam kënaqur nga njerëzit e mrekullueshëm që u kthyen në shtegun e besëlidhjeve dhe më pas shërbyen dhe e bekuan çdo njeri që e donin ose me të cilin komunikuan.

Shkrimet e shenjta dhe profetët e gjallë janë një mënyrë kryesore se si një Atë i dashur Qiellor e vë planin e Tij për lumturinë në dispozicion për të gjithë fëmijët e Tij.

Unë jap dëshminë time të sigurt për natyrën hyjnore të Jezu Krishtit dhe vërtetësinë e Shlyerjes së Tij, në emrin e Jezu Krishtit, amen.